



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT

Nr. 233 prot

Tiranë më 21/11/2023

Lënda: Raport informues për kufijtë kohorë të periudhës së komunizmit të përdorur në kontekst juridik gjatë regjimit komunist dhe pas rënies së tij dhe rekomandime

KUVENDIT TË SHQIPËRISË
Znj.Lindita Nikolla

**KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE TË
DREJTAVE TË NJERIUT**
Znj.Klotilda Bushka

Në zbatim të nenit 5, të Ligjit nr. 10242, 25 shkurt 2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, ISKK ka përgatitur një raport analistik për kufijtë kohorë të periudhës së komunizmit në Shqipëri, të vendosur gjatë regjimit komunist dhe pas rënies së tij. Raporti bazohet në vepra shkencore të krijuara nga ISKK, institucione të tjera të specializuara, ose individë me autoritet në fushën e historisë.

BAZA LIGJORE

ISKK është krijuar nga Kuvendi i Shqipërisë, me Ligjin nr. 10242, 25 shkurt 2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”. Detyrat kryesore të ISKK, parashikuar në këtë ligj, janë:

Neni 5:

- a) studion dhe vlerëson objektivisht periudhën e regjimit komunist;*
- b) analizon, studion dhe dokumenton krimet e kryera nga organet e diktaturës komuniste, si dhe pasojat gjatë dhe pas periudhës së komunizmit;*
- c) identifikon aktet ligjore dhe nënligjore, sekrete dhe jousekrete, të përgatitura apo të miratuara nga të gjitha institucionet, organet e autoritetet shtetërore dhe kushtetuese, të cilat kanë shërbyer si bazë e organizimit dhe e funksionimit të të gjithë aparatit të sistemit komunist;*

- ç) studion dhe vlerëson ndërtimin, organizimin institucional dhe veprimtarinë antidemokratike e kriminale të strukturave shtetërore, veçanërisht të organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit;
- d) studion dhe vlerëson veprimtarinë kriminale të Partisë Komuniste të Shqipërisë, më pas të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të organizatave të tjera, të krijuara në mbështetje të ideologjisë së saj;
- dh) analizon shkaqet dhe rrugët e vendosjes së regjimit komunist, dokumentet, që vërtetojnë përfshirjen e personave shqiptarë a të huaj, që mbështetën ardhjen e këtij regjimi, si dhe të atyre, të cilët bënë rezistencë kundër këtij regjimi;
- e) grumbullon të dhëna, dokumente dhe dëshmi për ndriçimin e veprimtarisë së organeve dhe të strukturave të Sigurimit së Shtetit, të formave të persekutimit dhe formave të rezistencës kundër tyre, si dhe të të gjitha veprimtarive, që kanë çuar në dhunimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist;
- ë) evidenton personat, që kanë qenë pjesë e organeve apo autoriteteve vendimarrëse, përgjegjëse për propagandën komuniste, për aktet administrative dhe vendimet, të cilat kanë çuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, në veprime represioni, në jetën shoqërore dhe kulturore, përfshirë luftën e klasave, kolektivizimin, luftën kundër fesë, izolimin nga Perëndimi, pamundësinë për t'u informuar dhe censurën në art, kulturë e shkencë, si dhe kufizimin e furnizimit me ushqime, përmes tallonave të ushqimit;
- f) vë në dijeni publikun për krimet dhe rrjetet e tjera të luftës së klasave;
- g) sistemon dhe boton kujtimet e të dënuarve politikë, qoftë të atyre që u burgosën, edhe të atyre që u persekutuan në kampet e internimit;
- gj) përpunon, në formë elektronike, të gjithë dokumentacionin për krimet e regjimit komunist në Shqipëri;
- h) publikon dhe përhap materiale të shkruara, në letër dhe në rrugë elektronike, si dhe organizon eksposita, seminare, konferanca e diskutime për krimet e komunizmit dhe pasojat e tij në Shqipëri;
- i) bashkëpunon me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së institutit;
- j) bashkëpunon me institucionet përgjegjëse të arsimit për përfshirjen, në planet dhe programet mësimore të shkollave të të gjitha niveleve, të informacionit të mjaftueshëm për krimet e komunizmit dhe të pasojave të tij në Shqipëri;
- k) bashkëpunon me institucionet homologe të huaja.

QËLLIMI

Ky raport ka për qëllimin analizimin e mënyrës së përcaktimit të kufijve kohorë të periudhës së komunizmit, në kuptimin e synuar për Ligjin nr. 10242, 25 shkurt 2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, para dhe pas amendimit të tij.

OBJEKTI

Kufijtë kohorë të periudhës së komunizmit, në kuptimin e një periudhe kohore e parashikuar për shtrirjen e veprimitarë studimore të ISKK, me qëllim *studimin objektiv të regjimit komunist deri në rënien e tij; studimin në mënyrë objektive të shkaqeve dhe rrugëve të vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri; vërtetimin e përfshirjes së personave shqiptarë a të huaj në vendosjen e atij regjimi; evidentimin e personave që bënë rezistencë, etj..*

METODOLOGJIA

Për përgatitjen e këtij raporti jemi bazuar në vepra të botuara nga ISKK, ose burime të tjera, të cilat përfshijnë një larmi gjinish: monografi, artikuj shkencorë, përbledhje dokumentesh, enciklopedi të ndryshme, etj. Raporti është përgatitur bazuar në metodat bazë që përdoren në punime të këtij lloji: hulumtimi, përshkrimi, krahasimi, sinteza dhe analiza. Metoda mbizotëruese e përdorur është analiza dhe ka qenë parësore përpjekja për ta ruajtur atë nga subjektiviteti dhe qëndrimet emocionale, me synim realizimin e një analize sa më të paanshme, në respektim të etikës dhe në përbushje të detyrimeve që rrjedhin nga nen 5, i Ligjit nr. 10242, 25 shkurt 2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, i ndryshuar.

PARASHTRIM I ARGUMENTIT TË RAPORTIT

Me ligjin nr. 129/2020, datë 22.10.2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10242, datë 25.2.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, Kuvendi i Shqipërisë ndryshoi përbajtjen e nenit 3, shkronja a. Këtu po japim të dy variantet e pikës a, të nenit 3, para dhe pas ndryshimit:

- Ishte:

“a) “*Periudha e komunizmit*” është *periudha e historisë së Shqipërisë nga 29 nëntori 1944 deri më 8 dhjetor 1990, si dhe periudha përpëra datës 29 nëntor 1944, gjatë së cilës është zhvilluar veprimitaria, që ka përgatitur ardhjen në pushtet të Partisë Komuniste të Shqipërisë, e cila, më pas, u shndërrua në Partia e Punës e Shqipërisë.*”

- U bë:

“a) “*Periudha e komunizmit*” është *periudha e historisë së Shqipërisë nga 29 nëntori 1944 deri më 8 dhjetor 1990*.”

Tre vitet e fundit, ISKK ka publikuar materiale të reja, studime shkencore dhe përbledhje dokumentesh, si dhe ka grumbulluar dokumente arkivore të reja, të cilat sigurojnë informacion të mjaftueshmë për të evidentuar mangësitë e përkufizimit ekzistues për kufijtë kohorë të periudhës së komunizmit në Ligjin nr. 10242, datë 25.2.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, i ndryshuar, dhe për të rekomanduar një variant të ri, të harmonizuar brenda kontekstit juridik dhe historik të kohës.

Në raport argumentohet që: 1) kufijtë kohorë të periudhës së komunizmit në Ligjin nr. 10242, datë 25.2.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, para dhe pas amendimit të tij, janë vendosur në mënyrë arbitrale; 2) amendimi që iu bë këtij ligji, me Ligjin nr. 129/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10242, datë 25.2.2010”, prishi koherencën në disa akte juridike të Kuvendit, të cilat trajtojnë përndjekjen politike gjatë regjimit komunist në Shqipëri.

Në fund të raportit jepen disa rekomandime për krijimin e një përkufizimi kohor për periudhën e komunizmit në Shqipëri në bazuar juridikisht dhe historikisht.

ARGUMENTET E PROPOZUESVE TË PROJEKTLIGJIT QË REZULTUAN NË NDRYSHIMIN E LIGJIT NR. 10242, 25.2.2010, “PËR INSTITUTIN E STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI” DHE KUNDËRARGUMENTET E ISKK

Më 5 qershor 2019, një grup deputetësh dorëzuan pranë Kuvendit një projektligj të titulluar “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10242, 25.2.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”.

Parantezë: Njëri nga firmëtarët e kërkesës për ndryshimin e ligjit, i cili kryesoi dhe një fushatë mediatike anti-ISKK gjatë vitit 2019, ka qenë gjyqtar gjatë regjimit komunist. Ndërkohë, gjykatat e regjimit komunist përkufizohen, nga ligji i ISKK, si organe të diktaturës. ISKK hulumton krimet e organeve të diktaturës dhe, për rrjedhojë, persona si ish-deputeti në fjalë kanë vepruar në konflikt interesit.

Duke parë relacionin shoqëruesh, projektligjin dhe ligjin e ndryshuar, vërehet që deputetët nuk kanë bërë dallimin mes dy koncepteve të ndryshme: “periudha e regjimit komunist në Shqipëri” dhe “periudha e komunizmit në Shqipëri.”

Relacioni nis me këtë fjali: “Projektligji propozohet për të saktësuar periudhën e regjimit komunist në Shqipëri në funksionin të objektit të ligjit.” “Periudha e regjimit komunist” nënkuption shtrirjen kohore mes dy datave, nga marrja e pushtetit prej komunistëve deri ditën e dorëzimit të tij. “Periudha e komunizmit”, në kuptimin e pikës a, nenii 3, të Ligjit nr. 10242, 25 shkurt 2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri” nënkuptione një hapësirë kohore të përcaktuar nga Kuvendi për të rregulluar ligjërisht hapësirën e veprimit të ISKK.

Periudha e regjimit komunist në ligjin original ishte 29 nëntor 1944-8 dhjetor 1990 dhe kështu mbeti dhe pas ndryshimit të ligjit. Pra, amendimi nuk solli asgjë të re në lidhje me ndryshimin e pretenduar. Amendimi ndryshoi përkufizimin kohor që ishte përcaktuar si hapësirë e lejueshme për ISKK të studionte krimet e komunizmit. Ligji në formën origjinale lejonte studimin e krimeve të komunizmit që në gjenezë të lëvizjes komuniste në Shqipëri, kurse pas ndryshimit të bërrë më 22 tetor 2020, ISKK iu hoq e drejta për të studiuar krimet e komunizmit në periudhën para datë 29 nëntor 1944.

Argumentet që u përdorën në vazhdim në mbrojtje të ndryshimit të ligjit ishin sipërfaqësore, të pabazuara, dhe të ngarkuar me retorikë nga narrativa e historisë së luftës e krijuar gjatë regjimit

komunist. Në vijim po analizojmë disa nga argumentet e propozuesve të projektligjit të sipërpermendur.

Argumenti 1: “*Dokumentat historike kanë treguar se Partia Komuniste Shqiptare [PKSH] e themeluar në 8 nëntor 1941 fitoi mbështetje popullore veçanërisht me programin politik dhe me platformën per krijimin e një fronti të gjerë lufte, ku do te merrnin pjesë pa dallim te gjitha forcat politike dhe antifashiste te vendit.*”

Kundërargumenti 1/1: Argumenti për “mbështetjen popullore” të PKSH, i cituar këtu sipas relacionit shoqëruar i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10242, 25.2.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, nuk është i bazuar. “Mbështetja popullore” që i atribuohet PKSH-se, nuk bazohet në rezultatin e një procesi zgjedhor, një referendumi, apo një sondazhi, të cilat mund të përdoren si burim referimi për të treguar mbështetjen ose jo të një subjekti politik. PKSH (PPSH) nuk mori kurrë pjesë në zgjedhje elektorale si subjekt politik periudhën 8 nëntor 1941 – 31 mars 1991. Ndërsa nuk është kryer kurrë ndonjë referendum, ose sondazh që të ketë vlerësuar popullaritetin e PKSH (PPSH).

Kundërargumenti 1/2: Më 1948, PKSH ndërroi emrin, nga Partia Komuniste Shqiptare e bëri Partia e Punës e Shqipërisë. Termin “komuniste” e hoqi me rekomandim të Stalinit, sepse popullsia e Shqipërisë ishte në shumicë fshatare dhe fshatarët kishin “frikë nga komunizmi”. “Stalini na tha se katundarët kanë frikë nga komunizmi”, tha Enver Hoxha, në plenumin e 7 të KQ të PKSH, 30 gusht-1 shtator 1947, pasi ishte kthyer nga një vizitë në Moskë.¹ Ndryshimi i emrit për shkak se fshatarësia nuk e donte komunizmin tregon se, “mbështetja popullore” e PKSH ishte e vogël, sepse fshatarësia përbënte 2/3 e popullsisë. Deklarata e Stalinit, deklarata e Hoxhës, ndryshimi i emrit të PKSH, numri i popullsisë fshatare dhe jo fshatare, janë gjëra të verifikueshme, të cilat u mbajtën sekret deri pas rënies së regjimit komunist.

Argumenti 2: “*Rregjimi komunist nuk mund të lidhet me periudhën e luftës Antifashiste Nacional-çlirimtare (në vijim "LANÇ"), luftë e cila u fitua me gjakun e mijëra dëshmorëve dhe siguroi pavarësinë e vendit.*”

Kundërargumenti 2/1: Veprimet, përfshi luftën partizane, kanë pasoja. Veprimet është mirë të gjykohen nga pasojat, jo qëllimi. Qëllimet mund të jenë të mira, por, mund të jenë dhe demagogji, mund të përdoren dhe për të mbuluar synime malinje.

Vendorja e regjimit komunist në Shqipëri ishte pasojë e luftës partizane, e cila u kthye në luftë civile,² mes komunistëve dhe antikomunistëve. Fitorja e luftës civile nga PKSH ishte kontribut i ushtrisë partizane. Pra, rezultati i luftës së ushtrisë partizane ishte vendorja e regjimit komunist, të cilin Kuvendi i Shqipërisë e ka njojur si regjim kriminal me një numër aktesh juridike. Ja disa prej tyre:

¹ AQSH, F. 14/APOU, V. 1947, D. 1, Fl. 100-102. Shënimë të Enver Hoxhës me titull “Ndërrimi i emrit të partisë”.

² Për luftën civile shiko: 1) *Historia e Shqiptarëve gjatë shekullit XX* (Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, 2021), 302-347; 2) Uran Butka, *Lufta civile në Shqipëri 1943-1945*, vëll. 1-2 (Tiranë: ISKK, 2015); 3) Luan Dode, *Partia Komuniste Shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore* (Tiranë: ISKK, 2020), 208-240.

1. *Ligji nr. 7514, datë 30.9.1991, i ndryshuar, "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë."*
2. *Ligjet nr. 7748, 29 korrik 1993, "Për statutin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist."*
3. *Ligji nr. 7698, datë. 15.4.1993, "Për kthimin dhe kompesimin e pronave ish-pronarëve."*
4. *Rezolutë për dënimin e krimeve të kryera nga regjimi komunist, 30 tetor 206.*
5. *Ligji nr. 9831, 12 nëntor 2007, "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist."*
6. *Ligji nr. 10242, 25.2.2010, "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri."*
7. Etj.

Kundërargumenti 2/2: Tekstet e luftës partizane, të botuar gjatë regjimit komunist, përgatiteshin me qëllimin për t'u përdorur si instrumente për indoktrinimin e shoqërisë. Lidhja e luftës me regjimin komunist është e pandashme, ose lidhja e tyre nuk mund të prishet pa krijuar një paradoks: ISKK i lejohet të ekzaminojë tekstet e luftës, por jo dokumentet e luftës. Kjo është njëloj si t'i kërkohet prokurorisë të zbulojë krimet, pa ekzaminuar vendin e ngjarjes për mbledhjen e provave. Në një farë mënyre, investigimi penal dhe studimor bazohen në të njëjtën filozofji: mblidhen provat, analizohen, formulohen konkluzionet.

Argumenti 3: *"Vetëm pas përfundimit te LANÇ, Fronti Demokratik, ku ishin të përfshire komunistët mori në dorë qeverisjen e vendit duke vendosur disa detyra, ndërmjet të cilave: elemizioni i kundershtareve politike, qeverisja e re, hartimi i Kushtetutes, reforma ekonomike etj."*

Kundërargumenti 3/1: Autorët e relacionit nuk e specifikojnë kur mbaroi LANÇ. Gjatë regjimit komunist u vendos si datë çlirimi data 29 nëntor 1944, por ISKK e ka dëshmuar me dokumente të bëra publike se ushtria partizane, ose njësi të mëdha të saj, luftonin në Shqipëri dhe jashtë saj edhe gjashtë muaj më pas kësaj date.³ Në katër vjet pushtim të Shqipërisë, ushtria pushtuese italiane vrau 207 partizanë (të cilët janë shpallur dëshmori); në shifra relative, partizanët e vrarë nga ushtria fashiste ishin 6% e partizanëve të vrarë gjatë gjithë luftës.⁴ Në dy vjet, 1944-46, forcat partizane vranë 359 persona (këtu nuk përfshihen të vrarët për qarkun e Shkodrës dhe Tiranën, se nuk janë llogaritur ende),⁵ kurse gjykatat ushtarake (partizane) dënuan me vdekje 794 persona.⁶ Gjithsej: 1153 persona, të vrarë, për arsy politike, brenda dy viteve.

³ Për luftën e forcave partizane brenda vendit, pas largimit të ushtrisë gjermane, shiko: 1) Florin Zyberaj, *Dokumente mbi Divisionin e Mbrojtjes së Popullit, vëll. I* (Tiranë: ISKK, 2022); 2) Çelo Hoxha, *Krimet e komunistëve gjatë luftës 1941-1945* (Tiranë: ISKK, 2014), 244-314; 3) AQSH, F. 14/AP, V. 1945, D. 2015. Për luftën e forcave partizane brenda dhe jashtë Shqipërisë, gjatë vitit 1945, shiko: 1) Uran Butka, *Lufta civile në Shqipëri 1943-1945*, vëll. 2 (Tiranë: ISKK, 2015), 274-400; 2) 1) *Historia e Shqiptarëve gjatë shekullit XX* (Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, 2021), 531-558.

⁴ *Historia e Shqiptarëve gjatë shekullit XX* (Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, 2021), 442.

⁵ Florin Zyberaj, *Dokumente mbi Divisionin e Mbrojtjes së Popullit, vëll. I* (Tiranë: ISKK, 2022), 713.

⁶ AQSH, F. 515, V. 1957, D. 15, Fl. 4. Raport për dënimet e dhëna nga gjykatat, 1945-1955.

Referuar sjelljes së ushtrisë partizane dhe numrit të viktimave të shkaktuara prej saj pas lufte, duket se kalimi i Shqipërisë nga gjendja e pushtimit dhe luftës, në gjendje çlirimi dhe paqeje nuk ka qenë një ndryshim cilësor.

Kundërargumenti 3/2: Autorët e relacionit shprehen se, “eleminimi i kundërshtarëve politikë” dhe “qeverisja e re” ishin shqetësime të pasluftës për PKSH, pa iu referuar asnje burimi shkencor. ISKK, një institucion i specializuar në studimet historike, ka botuar disa studime që vërtetojnë se vrasjet për arsyen politike nisen më 1942,⁷ fillimisht brenda PKSH, dhe se shqetësimet për “qeverisjen” kishin nisur që më 1942.⁸

DISA KUFIJ KOHORË TË VENDOSUR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË PËR EFEKTE JURIDIKE

Pas rënies së regjimit komunist, Kuvendit të Shqipërisë, si organi legjislativ, i është dashur të krijojë një bazë ligjore të veçantë për trajtimin e pasojave të regjimit komunist. Për këtë qëllim, përgjatë viteve kanë dalë numër aktesh juridike, në të cilat ka qenë e nevojshme të përcaktoheshin disa kufij kohorë për të përcaktuar fushën e efektshmërisë së atyre akteve juridike. Këtu po rendisim aktet më të rëndësishme:

1. *Ligji nr. 7514, datë 30.9.1991, i ndryshuar, “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë.”*

Neni 7/a, i këtij ligji, shtuar më 1993, sanksionon se të drejtat që burojnë nga ky ligj – pafajësia, e drejta e dëmshpërblimit, e kompèsimit, e shkollës, e rikthimit në vendet e banimit, etj. – u nijhen dhe familjeve të personave të vrarë “në përpjekje me forcat komuniste pas datës 1.8.1943,” nëse “motivet e saj provohen me vendim të gjykatës duke u marrë dhe mendimi i Shoqatës së ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë.”

Ky ligj sanksionon se një nga llojet e krimeve të komunizmit është vrasja politike e kryera nga forcat komuniste (partizane), **pas datës 1.8.1943**.

2. *Ligjet nr. 7748, 29 korrik 1993, “Për statutin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist.”*

Neni 2 i këtij ligji sanksionon se, “Përndjekje politike, që më poshtë do të quhet “përndjekje”, quhet çdo veprim ose mosveprim i kryer që nga data 8.11.1941 deri më datën 22.3.1992 nga ana e çdo formacioni ose individi të armatosur, e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, e sigurimit të shtetit, e policisë, e ushtrisë apo nga ana e organeve të

⁷ Për vrasjet politike shiko: 1) Enver Lepenica, *Eleminimi i grupit komunist të të Rinjve* (Tiranë: ISKK, 2016); 2) Çelo Hoxha, *Krimet e komunistëve gjatë luftës 1941-1945* (Tiranë: ISKK, 2014), 244-314; 3) Uran Butka, *Luftra civile në Shqipëri 1943-1945, vëll. 2* (Tiranë: ISKK, 2015); 4) Luan Dode, *Partia Komuniste Shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore* (Tiranë: ISKK, 2020).

⁸ Ky fakt pranohet thuajse në gjithë tekstet e historisë shkruar gjatë regjimit komunist. Shiko: 1) *Fjalori Enciklopedik Shqiptar* (Tiranë: Akademie e Shkencave, 1985), 470; 2) *Historia e PPSH, botimi dytë* (Tiranë: Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste, 1981), 90-95; *Material studimi për historinë e PPSH* (Tiranë: 1960), 142-146.

pushtetit lokal me urdhër, ose vendim të organeve partiake, luftarake, shtetërore apo të gjykatave të komunistëve shqiptarë, kur ky veprim ose mosveprim ka shkaktuar humbjen e jetës, të lirisë, të të drejtave qytetare, cilësimin kulak, i deklasuar, si dhe çdo privim tjetër nga pjesëmarrja në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore të individit për hir të bindjeve apo qëndrimit të tij politik a fetar.”

Ky ligj sanksionon se krimet politike të komunizmit fillojnë **më 8 nëntor 1941.**

3. *Ligji nr. 7698, datë. 15.4.1993, “Për kthimin dhe kompesimin e pronave ish-pronarëve.”*
Ky ligj njeh si prag të fillimit të dhunimit të pronës nga regjimi komunist datën **29 nëntor 1944**. Kjo datë gjatë regjimit komunist u përcaktua si dita e çlirimt të Shqipërisë nga ushtria gjermane.
4. *Ligji nr. 9831, 12 nëntor 2007, “Për dëmshpérblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist.”*
Ky ligj trajton u krijuat për të dëmshpérbyler financiarisht “ish të dënuarit politikë të regjimit komunist”. Kufijtë kohorë që ky ligj njeh si periudhë të persekutimit komunist janë **30.11.1944 – 1.10.1991**.
5. *Ligji nr. 10242, 25.2.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.”*
Ky ligj ka pasur dy përkufizime për periudhën e komunizmit. Një, periudhën “nga 29 nëntori 1944 deri më 8 dhjetor 1990, si dhe periudha përpara datës 29 nëntor 1944, gjatë së cilës është zhvilluar veprimitaria, që ka përgatitur ardhjen në pushtet të Partisë Komuniste të Shqipërisë.” Dhe, dy, me ndryshimet e vitit 2020, që janë ende në fuqi, periudha e komunizmit u përcaktua “**nga 29 nëntori 1944 deri më 8 dhjetor 1990.**”

ANALIZË E KUFIJVE KOHORË TË VENDOSUR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

LIDHUR ME KONCEPTIN E PËRNDJEKJES POLITIKE DHE KRIMIT POLITIK

Ligjet e sipërcituara, ndryshtë të referuara dhe si ligje të drejtësisë tranzitore, kanë objekt dhe qëllim të ndryshëm nga njëri-tjetri, por të gjithë trajtojnë të shkuarën komuniste të shoqërisë shqiptare.

Disa prej tyre janë shoqëruar me pasoja financiare dhe një nga mënyrat që hartuesi ligjor ka përdorur për zvogëlimin e barrës financiare të tak sapaguesit ka qenë përcaktimi i një kufiri kohor sa më të ngushtë si periudhë e regjimit komunist.

Në rastin e marrëdhënieve fiannciare, si dëmshpérblimi i vuajtjes së persekutimit, ose kompescimi i pronës, kufizimi i periudhës së komunizmit ka qenë i imponuar dhe nga fakti i marjes së pushtetit nga komunistët. Vrasjet politike, për shembull, kanë ndodhur që pas organizmit ushtarash të komunistëve, ndërsa shpronësimi, në emër të institucioneve, fillon kur komunistët morën kontrollin e institucioneve, pra, kur ata morën pushtetit në një zonë të caktuar apo në gjithë Shqipërinë.

Qasja konceptuale e Kuvendit ka qenë parimore dhe etike, por problemet kanë buruar nga mënyra e përcaktimit të datës së fillimit të sundimit komunist. Dy nga ligjet e mësipërme kanë si

datë fillimi të pushtetit komunist datën 29 nëntor 1944 dhe 30 nëntor 1944, të cilat, në gjykimin tonë, janë vendosur në mënyrë arbitrale.

Regjimi komunist e kishte përcaktuar datën e fillimit të pushtetit tij, siç do ta shohim në vijim, bazuar në dokumente që patën pasoja juridike.

FILLIMI I PUSHTETIT KOMUNIST NË AKTET LIGJORE TË REGJIMIT KOMUNIST DHE NË STUDIMËT E AKADEMISË SË SHKENCAVE

Çdo institucion shtetëror dhe veprintari institucionale nis, ose duhet të nisë, bazuar në një akt juridik, i cili është krijuar nga një autoritet i autorizuar për të nxjerrë akte të tillë. Edhe regjimi komunist, pavarësisht arbitraritetit gjerësisht të përhapur në fushën e respektimit të ligjeve, në përcactimin e pragut të fillimit të tij e ka respektuar këtë parim.

Regjimi komunist njihte si fillim të pushtetit të tij datën 24 maj 1944. Këtë pohim e mbështesim në dy dokumente të rëndësishme: *Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë* (1946), neni 94 (96, pas vitit 1950), *Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë* (1976), neni 109. Neni 94 (njëloj me nenin 96, 109) sankziononte që: “*Stema e shtetit të Republikës Popullore përfaqëson një fushë të përshtjellur me dy tufa kallnj gruri. Tufat me kallnj gruri lidhur në funt me kordhela, ku është shkruar data 24 maj 1944.*”

Rëndësia që kishte Kongresi i Përmetit për PKSH, i cili filloi punimet më 24 maj 19944, është shprehur në deklaratën që Kongresi harto më 24 maj 1944.⁹ Data e fillimit të punimeve të këtij kongresi, i cili krijoj institucionet e pushtetit komunist, Këshillin Antifashist Nacionalçlirimtar me atribute legjislative dhe Komitetin Antifashist Nacionalçlirimtar me atribute ekzekutive, e cila vërtetohet me botimin e saj në Gazetën Zyrtare, ishte aprovuar nga Kuvendi (i quajtur Popullor atëherë), si dita e fillimit të regjimit komunist.

Në *Fjalorin Enciklopedik Shqiptar*, botim i Akademisë së Shkencave (2009), faqe 497, Komiteti Antifashist Nacionalçlirimtar, i krijuar në Përmet më 27 maj 1944, përkufizohet si “*organi më i lartë ekzekutiv dhe urdhërdhënës i pushtetit popullor në Shqipëri gjatë Luftës ANÇ.*” Në po atë vepër, faqe 894, pranohet fakti që Komiteti Antifashist Nacionalçlirimtar u emërtua Qeveri Demokratike më 22 tetor 1944, në Berat, dhe ushtroi funksionin deri më 22 mars 1946, por, si fillim i qeverisjes komuniste, në faqen 2163, pranohet data 28 maj 1944.

ANALOGJI HISTORIKE PËR KRIJIMIN E ENTITETEVE TË PËRKOHSHME ME ATRIBUTET E NJË QEVERIE

Në vijim, po japim disa raste në historinë e Shqipërisë, kur, për shkak të ndryshimeve të mëdha të pushtetit, qeverisja ka nisur fillimisht me një entitet të përkohshëm, i cili ka kryer detyra ekzekutive deri në krijimin e një qeverie të rregullt, të emëruar nga një organ legjislativ. Përfshi rastin e komunistëve.

- 1) *Komiteti administrativ i Përkohshëm, 8 prill – 12 prill 1939*

⁹ *Gazeta Zyrtare*, nr. 1, 21 dhjetor 1944, 1-3. Deklaratë e Kongresit të Përmetit, 24 maj 1944.

Më 7 prill 1939, me largimin e Mbretit Zog I dhe qeverisë së tij nga Shqipëria, në vend u krijuat një vakum pushteti. Në studimet historike, është pranuar si datë e fillimit të pushtetit fashist data 8 prill 1939, kur u krijuat një entitet i quajtur Komiteti Administrativ i Përkoħshem me atributet ekzekutive. Krijimi i Komitetit vërtetohet me një dokument të nxjerrë nga vetë Komiteti. Dokumenti është një qarkore e cila njofton se, “me pëlqimin e Legatës Mbretnore Italjane”, ishte krijuar “nji Komitet Administrativ me qëllim të sigurohet rregulli e disciplina në të gjith Shqipnin.”¹⁰ Aktiviteti i Komitetit zgjati 4 ditë. Më 12 prill 1939, Asambleja Kushtetuese emëroi një qeveri të pérherershme.

2) Komitet Ekzekutiv të Përkoħshem 14 shtator – 5 nëntor 1943

Pas kapitullimit të Italisë (8 shtator 1943), në Tiranë u mblodh (14 shtator 1943) një grup njerëzish me influencë, të cilët krijuan një Komitet Ekzekutiv të Përkoħshem (KEP). Komiteti deklaroi të rrëzuar qeverinë “e ditëve të robnisë” dhe se do të punonte për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar, “prej gjinit të së cilës do të dali Qeverija”.¹¹ Kuvendi u krijuat më 18 tetor 1943, Këshilli i Naltë emëroi qeverinë më 5 nëntor 1943. Vendimet e KEP u aprovuan nga Kuvendi Kombëtar.¹²

3) Komiteti Antifashist Nacionalçlirimtar, 27 maj – 22 tetor 1944

Më 24-28 maj 1944 u mbajt Kongresi i Përmetit, i cili ishte një kongres i PKSH. Kongresi krijoit Këshillin Antifashist Nacionalçlirimtar (KANÇ), me atributet e një organi legjislativ.¹³ KANÇ-emëroi një organ ekzekutiv, të quajtur Komiteti Antifashist Nacionalçlirimtar.¹⁴ Më 22 tetor 1944, KANÇ-i i ndërroi emrin Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar në Qeveria Demokratike e Shqipërisë. Kjo qeveri qëndroi në Berat deri më 27 nëntor 1944; në Tiranë u vendos më 28 nëntor 1944. Pavarësisht vendodhjes, entitetet ekzekutive komuniste (Komiteti Antifashist Nacionalçlirimtar dhe Qeveria Demokratike) funksionuan pa ndërprerje prej 27 maj 1944 deri më 21 mars 1946. Gjithë aktet e nxjerra nga Kongresi i Përmetit dhe KANÇ-i u aprovuan nga Asambleja Kushtetuese më 11 janar 1946.

Në ndryshim nga dy rastet pararendëse, Komiteti Antifashist Nacionalçlirimtar nuk u krijuat përtë mbushur një boshllék pushteti. Kongresi i Përmetit deklaroi se nuk e njihet qeverinë ekzistuese dhe kështu krijoit një qeveri paralele.

RËNDËSIA E NDRYSHIMIT TË PËRKUFIZIMIT PËR PERIUDHËN E KOMUNIZMIT NË LIGJIN NR. 10242, 25 SHKURT 2010, “PËR INSTITUTIN E STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI”, I NDRYSHUAR

¹⁰ AQSH, F. 149-1. D.45, Fl. 6. Qarkore e Komitetit Administrativ, 8 prill 1939.

¹¹ AQSH, F. 556, V. 1944, D. 21, Fl. 2. Deklaratë e Komitetit të Perkoħshem, titulluar “Thirrje Kombit”.

¹² *Fletore Zyrtare*, nr. 108, 13 dhjetor 1943, 3. Ligj, nr. 5, 21 tetor 1943, Mbi rikrijimin e Ushtris Shqiptare.

¹³ *Gazeta Zyrtare*, nr. 1, 21 dhjetor 1944, 1.

¹⁴ *Gazeta Zyrtare*, nr. 1, 21 dhjetor 1944, 4.

Vitin e kaluar ISKK botoi përbledhjen dokumentare me titull “Raport për marrëdhëniet ekonomike Shqipëri Jugosllavi 1945-1948”. Ky libër është një raport zyrtar, i përgatitur nga ministria e Financave, më 1949, për marrëdhëniet ekonomike të Shqipërisë me Jugosllavinë. Mes shumë gjëra që thuhen në raport, Jugosllavia akuzohet se kishte dashur ta kthente Shqipërinë në një koloni të saj. Lexuesi i këtij rapporti, nuk është në gjendje të kuptojë pse Jugosllavia ishte shteti i parë që njohu qeverinë komuniste shqiptare? Pse qeveria shqiptare pranoi atë marrëveshje ekonomike disfavorizuese me Jugosllavinë? Pse PKSH dhe qeveria e Tiranës nuk mbajtën anën Nako Spirut, kur ai kritikoi marrëdhëniet ekonomike Shqipëri-Jugosllavi? Këto pyetje marrin përgjigje, nëse ISKK i lejohet të shkruajë për historinë e PKSH dhe të komunizmit në Shqipëri para datës 29 nëntor 1944, duke trajtuar rolin e komunistëve jugosllavë në themelimin e PKSH, në organizimin e saj, në luftën e brendshme të PKSH, në krijimin e ushtrisë partizane, pse PKSH merrte urdhra nga Tito, siç ishte ekzekutimi i Llazar Fundos, etj.

Një aspekt tjetër është që, në vitet e para të regjimit komunist, janë dënuar shumë kundërshtarë të atij regjimi si kolaboracionistë, si anëtarë të formacioneve politike rivalë me PKSH, si kriminelë lufte, etj. Shumë prej tyre janë dënuar me akuza fals. Si mund t'i hetojnë specialistët e ISKK këto gjyqe, kur nuk mund të hetojnë periudhën gjatë së cilës mendohet se ka ndodhur vepra për të cilën akuzohen, sepse ka ndodhur para datës 29 nëntor 1944?

Ky shqetësim nuk është i kufizuar vetëm në këto dy shembuj, por besojmë se janë të majftueshëm për të kuptuar pengesat që ndesh ISKK në përpjekje për të përbushur detyrën ligjore, për shkak të ndryshimeve që u bënë me Ligjin nr. 129/2020, datë 22.10.2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10242, datë 25.2.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”.

PËRFUNDIME

Bazuar në argumentet e parashtruar në këtë raport mendojmë se korrigjimi i kufijve të periudhës së komunizmit në Ligjin nr. 10242, 25 shkurt 2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, i ndryshuar, dhe akte të tjera juridike, është i domosdoshëm për disa arsyet:

- Mundëson Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit të ushtrojë përgjegjësinë e tij hulumtuese dhe studimore pa pengesa dhe kufizime të panatyrshme për fushën e shkencave historike.
- Mundëson publikun shqiptar të informohet në mënyrë më të plotë me të rejet shkencore të ISKK, të realizuara në përbushje të detyrës ligjore të tij.
- Shmang inkoherençën në disa akte juridike të Kuvendit lidhur me trajtimin e të shkuarës komuniste.
- Mundëson Kuvendin ta bazojë vendimarrjen e tij, për përcaktimin e kufijve kohorë të periudhës së komunizmit në Shqipëri, në vepra rigorozisht shkencore, realizuar nga një institucion që Kuvendi e ka krijuar qëllimisht për një punë të tillë.

REKOMANDIME

1.

Bazuar në argumentet e parashtuar në këtë raport, ISKK i kërkon Kuvendit ndryshimin e pikës a, neni 3, të Ligjit nr. 10242, 25 shkurt 2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, i ndryshuar:

“a) “Periudha e komunizmit” është periudha e historisë së Shqipërisë nga 24 maj 1944 deri më 29 prill 1991, si dhe periudha përpara datës 24 maj 1944, gjatë së cilës është zhvilluar veprimtaria, që ka përgatitur ardhjen në pushtet të Partisë Komuniste të Shqipërisë, e cila, më pas, u shndërrua në Partia e Punës e Shqipërisë.”

2.

Bazuar në argumentet e parashtuar në këtë raport, ISKK i rekomandon Kuvendit të Shqipërisë ndryshimin e përkufizimit kohor të periudhës së regjimit komunist në aktet ligjore që ai e shikon të arsyeshme, disa prej të cilëve janë përmentur në këtë raport. Ky përkufizim mund të paraqitet në këtë formë:

“Periudha e regjimit komunit” është periudha e historisë së Shqipërisë prej 24 maj 1944 deri më më 29 prill 1991.¹⁵

3.

Duke pasur parasysh argumentin e përmendorur në këtë raport lidhur me një deputet, i cili ka qenë pjesëtar i organeve të diktaturës komuniste, i rekomandojmë Kuvendit që persona të tillë, nëse janë anëtarë të Kuvendit, t'i konsiderojë në konflikt interesit dhe t'u kërkojë të mos shprehen ose të mos votojnë për çështje që lidhen me ISKK.

BIBLIOGRAFI:

Artikuj shkencorë:

- Afrim Krasniqi, “Baza dhe konceptet kushtetuese në vendimarrjet mbi sistemin qeverisës: Analizë krahasimore, vitet e para (1945-1946) dhe të fundit (1990) të regjimit komunist,” në: *Memoria I*, nr. 1, 45-67.
- Çelo Hoxha, “Kontruksioni ligjor i regjimit komunist në Shqipëri.” *Memoria I*, nr. 1, 9-44.

Studime shkencore/monografi:

¹⁵ Aspektet juridike të procesit demokratik në Shqipëri janë trajtuar në artikullin: Afrim Krasniqi, “Baza dhe konceptet kushtetuese në vendimarrjet mbi sistemin qeverisës: Analizë krahasimore, vitet e para (1945-1946) dhe të fundit (1990) të regjimit komunist,” në: *Memoria I*, nr. 1, 45-67.

- Luan Dode, *Partia Komuniste Shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore* (Tiranë: ISKK, 2020), 208-240.
- Uran Butka, *Luftha civile në Shqipëri 1943-1945*, vëll. 1-2 (Tiranë: ISKK, 2015).
- *Fjalori Enciklopedik Shqiptar* (Tiranë: Akademia e Shkencave, 1985).
- *Fjalori Enciklopedik Shqiptar* (Tiranë: Akademia e Shkencave, 2009).
- *Historia e PPSH, botimi dytë* (Tiranë: Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste, 1981), 90-95.
- *Historia e Shqiptarëve gjatë shekullit XX* (Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, 2021), 302-347.
- *Material studimi për historinë e PPSH* (Tiranë: 1960), 142-146.

Përbledhje me dokumente:

- Çelo Hoxha, Florin Zyberaj, *Raport për marrëdhëniet ekonomike Shqipëri Jugosllavi 1945-1948* (Tiranë: ISKK, 2022).
- Çelo Hoxha, *Krimet e komunistëve gjatë luftës 1941-1945* (Tiranë: ISKK, 2014).
- Enver Lepenica, *Eleminimi i grupit komunist të Rinjeve* (Tiranë: ISKK, 2016); 2)
- Florin Zyberaj, *Dokumente mbi Divisionin e Mbrotjes së Popullit*, vëll. I (Tiranë: ISKK, 2022).
- Ndreçi Plasari, Luan Malltezi, *Enver Hoxha dhe katër ditët e Beratit* (Tiranë: 55, 2007).
- Ndreçi Plasari, Luan Malltezi, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948* (Tiranë: DPA, 1996).

Dokumente:

- AQSH, F. 14/AP, V. 1945, D. 215.
- AQSH, F. 149-1. D. 45.
- AQSH, F. 515, V. 1957, D. 15.
- AQSH, F. 556, V. 1944, D. 21.

Fletore zyrtare:

- *Fletore Zyrta*, nr. 108, 13 dhjetor 1943.
- *Gazeta Zyrta*, nr. 1, 21 dhjetor 1944.

